

1 E enjte, 2 dhjetor 2021

2 [Konferencë përgatitore për Mbrojtjen]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari Gucati hyn në sallën e gjyqit]

5 [I akuzuari Haradinaj merr pjesë përmes
6 videolidhjes]

7 --- Seanca fillon në orën 09.30

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zonja
9 Sekretare, të lutem thirr çështjen.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Është
11 çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër Nasim
12 Haradinajt dhe Hysni Gucatit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
14 Mirëmëngjes, të gjithëve. Mirë se keni ardhur.

15 Ju lutem, palët të prezantohen duke filluar me
16 Prokurorinë.

17 Z. PACE: [Përkthim] Mirëmëngjes Trupit Gjykes dhe të
18 gjithëve të pranishëm dhe atyre që ndjekin nga larg.

19 Ne, si Prokurori, kemi Valeria Bolici, Prokurore; Line
20 Pederson, Menaxhere e Çështjes dhe e Provave; Matt Halling,
21 Zëvendësprokuror; dhe unë jam James Pace, Zëvendësprokuror.

22 Z. REES: [Përkthim] Përfaqësoj z. Gucati. Ndhimohem nga
23 Huw Bowden dhe Eleanor Stephenson. Sot ndihmohem dhe nga Faye
24 Wignore, Joseph Bawden dhe Muharrem Halilaj.

25 Z. CADMAN: [Përkthim] Përfaqësoj z. Haradinaj, i cili e

1 ndjek nga larg. Këtu i pranishëm me mua është zonja Clarissa
2 Rodio, Admir Berisha dhe nga larg Miriam Boxberg.

3 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve. Unë jam
4 Ralph Roche nga Administrata, nga shërbimet gjyqësore të Zyrës
5 Administrative.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vë re se
7 zoti Gucati është i pranishëm, ndërsa zoti Haradinaj e ndjek
8 procedurën nga larg, sikurse vuri në dukje zoti Cadman.

9 Sot, po zhvillojmë Konferencën e Përgatitjes së Mbrojtjes
10 që i paraprin hapjes së çështjes së Mbrojtjes.

11 Për të mirën e publikut, kujtoj që Prokuroria e hapi
12 çështjen e saj në 7 tetor dhe paraqiti të dhëna nga data 18
13 tetor deri në 5 nëntor. Prokuroria zyrtarisht e mbylli
14 çështjen e vet në 10 nëntor të këtij viti.

15 Në 26 nëntor, Trupi Gjygues vendosi të mos hidhte poshtë
16 asnjë nga akuzat e Prokurorisë në këtë fazë. Ai vendim i hapi
17 rrugën Mbrojtjes për hapjen e çështjes së Mbrojtjes në qoftë
18 se të akuzuarit kështu preferuan.

19 Në 29 nëntor, në përputhje me rregullin 119, të dy të
20 akuzuarit dorëzuan listat e dëshmitarëve të propozuar.
21 Mbrojtja e Gucatit propozoi listën e provave të propozuara në
22 30 nëntor.

23 Trupi Gjygues nxori një urdhër për kalendarin e punës për
24 përgatitjen e konferencës së Mbrojtjes do të mbahet sot dhe në
25 qoftë se është e nevojshme, nesër.

1 Qëllimi i kësaj konference është të përgatitet çështja e
2 Mbrojtjes. Do të shqyrtojmë agjendën dhe urdhrin e kalendarit
3 dhe do të trajtojmë disa çështje të cilat i kanë ngritur palët
4 deri dje mbase.

5 Pika e parë e programit janë deklaratat hapëse.

6 Në qoftë se Mbrojtja konfirmon se do të bëjnë deklaratë
7 hapëse; dhe në qoftë se kështu, do t'i bëhen të dyja të hënën
8 6 dhjetor, apo deklaratë hapëse e Haradinajt do të bëhet pasi
9 të përfundojë Mbrojtja e zoti Gucati?

10 Zoti Rees, do të bëni deklaratë hapëse?

11 Z. REES: [Përkthim] Po. Dhe besoj që do të vazhdojë deri
12 45 minuta. Mund ta bëjmë në 6 dhjetor. Mund ta bëjmë dhe më
13 herët, nëse ju si Trup Gjykes dëshironi kështu.

14 Dhe besoj se me këtë iu përgjigja kërkesës lidhur me
15 çështjen e zoti Gucati.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

17 Faleminderit, zoti Rees.

18 Zoti Cadman.

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë ndoqa një njoftim shumë të
20 shkurtër sot në mëngjes. Sepse u paraqit sot në mëngjes. në
21 fakt. Qëllimi i Mbrojtjes së zoti Haradinaj është të bëjë, të
22 mbajnë një deklaratë hapëse, po këtë do ta bëjmë pasi të
23 përfundojë deklaratë e zotit Gucati.

24 PËRKTHYESJA: Gjykatësi nuk e ka të hapur mikrofonin.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Tema

1 tjetër është prania e të akuzuarit në sallën e gjyqit gjatë
2 paraqitjes së dëshmive nga Mbrojtja.

3 Në dritën e situatës së COVID-it, duhet të marrim
4 parasysh skenarë kur të akuzuarit mund të mos jenë të
5 pranishëm në sallën e gjyqit. Sa për sqarim, Trupi Gjykses do
6 të preferonte, sigurisht, që të akuzuarit të ishin të
7 pranishëm personalisht, por e dimë që nuk është gjithmonë e
8 mundur për shkak të kufizimeve të lidhura me COVID-in.

9 Së pari do t'ia jap fjalën Zyrës Administrative.

10 Duam të dimë nëse të akuzuarit mund t'i ndjekin
11 procedurat nga objekti i paraburgimit nëse nuk do të jenë të
12 pranishëm në dhomë, përfshirë edhe situata karantine.

13 Z. ROCHE: [Përkthim] Faleminderit.

14 Në rast se ndodh kjo, që bazuar në këshillat e mjekut, që
15 të akuzuarit nuk do të jenë të pranishëm këtu apo për shkak të
16 karantinës, kemi marrë masat që ata t'i ndjekin procedurat
17 sipas objektit të paraburgimit.

18 Kështu që përgjigja është po, mund të mundësohet.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Edhe në
20 qoftë se është në karantinë?

21 Z. ROCHE: [Përkthim] Po, edhe atëherë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund t'i
23 thoni Trupit Gjykses nëse do të zbatohet ndonjë kufizim për
24 mundësinë që avokatët të kenë qasje tek klientët e tyre në
25 këtë fazë; dhe, nëse ka çfarë kufizimesh zbatohen?

1 Z. ROCHE: [Përkthim] Aktualisht nuk ka. Por do të
2 fillojnë në 6 dhjetor. Të akuzuarit mund të mbajnë kontakte
3 telefonike me avokatët e tyre gjatë gjithë kohës sipas nevojës
4 dhe në rast se do të jenë të detyruar të izoloohen, në bazë të
5 këshillave mjekësore. Dhe gjithashtu do të mundësojmë
6 komunikime me Zoom midis të akuzuarve dhe avokatëve të tyre.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
8 Faleminderit, zoti Roche.

9 Besoj që Mbrojtja parapëlqen që të akuzuarit të jenë në
10 sallën e gjyqit, por tani do t'jua jap fjalën zoti Rees të
11 flisni për këtë çështje.

12 Nuk e di nëse keni diçka.

13 Z. REES: [Përkthim] Zoti Gucati është këtu. Ai ka qenë i
14 pranishëm gjatë të gjithë gjyqit dhe shpresojmë që të jetë i
15 pranishëm gjatë të gjithë kohës, me përjashtim të ngjarjeve të
16 paparashikuara.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
18 Cadman, a mund t'i thoni Trupit Gjykses nëse problemi që
19 ngritët dje, lidhur me sistemin e sigurtë të nxjerrjes së
20 materialeve, është zgjidhur apo jo?

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Po, është zgjidhur. Tani mund t'i
22 kalojmë dokument në mënyrë të sigurtë.

23 Do të thosha në rastin e zotit Haradinaj është pak e
24 ndryshme situata, sepse vazhdon të shfaq shenja të COVID-it.
25 Siç tha zoti Roche, nuk kemi qasje të drejtpërdrejtë përveç

1 komunikimeve të sigurta elektronike. Sigurisht, që kjo na
2 krijon probleme sepse duhet të marrim udhëzime kur të fillojë
3 gjyqi. Prandaj, do të ishte e këshillueshëm, siç kemi
4 sugjeruar, që Mbrojtja e Gucatit të ishte e para e pastaj
5 Mbrojtja e Haradinajt të vinte më pas nesh. Kjo do të më
6 mundësonte të kisha kontakte me zoti Haradinaj kur të
7 paraqisnim çështjen.

8 Për momentin, jemi të informuar se do të rrijë në
9 karantinë deri nesër të paktën. Nuk e dimë -- nuk e kanë bërë
10 testin ende, se siç thashë paraqet simptoma. Kur ta dimë, me
11 siguri do të vijojmë. Ato që na ka udhëzuar zoti Haradinaj
12 është që pamundësia e tij të jetë i pranishëm në Gjykatë të
13 mos pengojë ecurinë e çështje, sepse ai do që kjo çështje të
14 vazhdojë.

15 Këto janë udhëzimet e mia. Sigurisht, në qoftë se s'kam
16 kontakte do të më kufizojnë në mundësinë e paraqitjes së
17 çështjes.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E
19 vlerësojmë bashkëpunimin dhe durimin e të gjithë palëve që
20 keni treguar, sigurisht, që është ne kemi për synim që të
21 vazhdojmë punën me qëllim që të mund të dalim me një përfundim
22 sa më shpejtë që të jetë e mundur.

23 Zoti Haradinaj, ju falënderojmë për praninë tuaj sot këtu
24 dhe shpresojmë, urojmë shërim të shpejtë.

25 Tema tjetër është problemet që ka ZPS-ja lidhur me

1 çështjen e dëshmitarëve të Mbrojtjes. Kjo çështje lidhet me
2 autoritetin e Trupit Gjykses për të përcaktuar numrin e
3 dëshmitarëve të Mbrojtjes gjatë kësaj konference.

4 Përpara se të flasim për këtë temë, nevojitet një
5 historik procedural.

6 Në 12 korrik 2021, Mbrojtja dorëzoi dosjet paragjyqësore
7 përkatëse bashkë me listat e përkohshme të dëshmitarëve të
8 propozuar. Dy listat ishin identike me përjashtim të një
9 dëshmitari të propozuar në listën Haradinaj.

10 Në 21 korrik, Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen të
11 parashtrojë një përmbledhje të fakteve apo të rrethanave në
12 lidhje me të cilat çdo dëshmitar i listës provizore të
13 Mbrojtjes do të dëshmonte.

14 Në 27 gusht, sipas urdhrit të 21 korrikut, Mbrojtja bëri
15 parashtrime shtesë lidhur me rëndësinë e propozuar të këtyre
16 dëshmitarëve.

17 Në 15 shtator, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë për të hequr
18 pesë dëshmitarë nga listat e Mbrojtjes dhe të kufizojë
19 dëshminë e pesë dëshmitarëve të tjerë lidhur me çështje që
20 lidhen me akuzat.

21 Në 27 shtator, Mbrojtja iu përgjigj kërkesës së ZPS-së.

22 Në 15 tetor, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi raportin
23 ekspert të dëshmitarit të parë të propozuar si ekspert.

24 Në 22 tetor, ZPS-ja dorëzoi kundërshtimin e këtij
25 raporti.

1 Në 9 nëntor, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi raportin e
2 dytë për ekspertin të një dëshmitari ekspert të propozuar.

3 Në 16 nëntor, ZPS-ja dorëzoi kundërshtimin e saj edhe
4 ndaj këtij raporti.

5 Në 29 nëntor, Mbrojtja parashtroi se parashtrimet e saj
6 sipas rregullit 119 janë këto: Mbrojtja e Gucatit dorëzoi një
7 listë me tetë dëshmitarë të propozuar, nga të cilët dy janë të
8 rinj në kuptimin që nuk përmenden në listën provizore të
9 dëshmitarëve. Një prej këtyre të rinjve, është zoti Gucati.

10 Mbrojtja e Gucatit parashtrojë gjithashtu një listë të
11 provave materiale të propozuara.

12 Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi një listë me shtatë
13 dëshmitarë të propozuar, nga të cilët dy janë të rinj dhe një
14 prej atyre është zoti Haradinaj.

15 Mbasi kanë shqyrtuar listën e re të dëshmitarëve, Trupi
16 Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk synon më të thërrasë tetë
17 dëshmitarët që ishin listuar në dy listat fillestare të
18 dëshmitarëve. Pesë prej tyre u kundërshtuan nga ZPS-ja, pra,
19 këto nuk pranohen.

20 Në 1 dhjetor, ZPS-ja parashtroi një kundërshtim të ri që
21 kërkon nga Trupi Gjykses të heqë dëshmitarin e Mbrojtjes 1248
22 nga lista e dëshmitarëve të Gucatit dhe të mos autorizojë
23 dëshmi të papërshtatshme për opinion lidhur me pesë
24 dëshmitarët; katër në listën e Gucatit dhe një në atë të
25 Haradinajt.

1 Mbrojtja e Haradinajt, gjithashtu, parashtroi me vonesë
2 një listë të provave të propozuara.

3 Trupi Gjykses i bën thirrje që të trajtohet kjo çështje
4 në qoftë se është nevoja në seancë private.

5 Zoti Prokuror, të ftoj të bësh ndonjë parashtrim tjetër
6 lidhur me çështjen e dëshmitarëve që mund të thërrasë
7 Mbrojtja. Meqenëse keni bërë një parashtrim dje, besoj që
8 s'keni shumë gjëra për të shtuar, megjithatë nëse keni, keni
9 fjalën në këtë çast.

10 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Me lejen tuaj, do t'i
11 kthehem dhe një herë deklaratave hapëse në dritën e asaj që
12 tha Mbrojtja e zoti Haradinaj.

13 Nuk duket se është një situatë e parashikuar në bazë të
14 rregullit 101(2)(6)(2) [sipas përkthimit] që Mbrojtja ka të
15 drejtë ta bëjë këtë mbas deklaratës hapëse të Prokurorisë.

16 Paraqitja e provave të Mbrojtjes do të fillojë javës që
17 vjen dhe Mbrojtja dhe dëshmitarët do të thirren në bazë të
18 listave që janë paraqitur. Dhe besoj që -- ne nuk e kemi të
19 qartë nëse propozimi i bërë nga Mbrojtja e Haradinajt është e
20 pranueshme apo logjike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju keni
22 kundërshtim?

23 Z. PACE: [Përkthim] Nuk më duket se parashikohet si
24 mundësi sipas Rregullores. Por, sigurisht, ju e dini në qoftë
25 se është e pranueshme për sa i takon përputhshmërisë me

1 rregullën nuk duket, nuk përputhet. Ne, si Prokurori, duam që
2 hapja e Gucatit dhe e Haradinajt të bëhen në të njëjtën kohë,
3 pra, përpara hapjes së çështjes së Mbrojtjes.

4 Por, në qoftë se ju nuk e shikoni si problem, atëherë nuk
5 diskutohet më.

6 Tani do t'i kthehem pikës së agjendës aktuale. ZPS-ja i
7 përmbahet kërkesës në lidhje me dëshmitarët e Mbrojtjes duke
8 qenë se Mbrojtja ka vendosur të mos thërrasë disa dëshmitarë.

9 Do të bëj disa parashtime të shkurtra pa përsëritur ato
10 që kemi paraqitur në parashtimet tona F312, 338, 438 dhe 466.

11 Në 30 nëntor dhe 1 dhjetor Mbrojtja nxori listat e
12 dëshmitarëve të adresuar në parashtimin tonë 312. Pra, këto
13 deklarata lidhen me dëshminë e propozuar të disa dëshmitarëve
14 edhe pamundësinë e tyre [që] të ndihmojnë Trupin Gjykses.

15 Përpara se të kalojmë tek çështjet e mëtejshme, kërkoj
16 sqarim ose nga Mbrojtja ose nga Trupi Gjykses. Dua të ngre
17 disa çështje të ngritura, konkretisht, në deklaratat që i janë
18 dhënë Prokurorisë. E di që deklaratat e dëshmitarëve të
19 bashkëngjitur parashtimeve të Haradinajt janë parashtruar në
20 mënyrë konfidenciale. Por, nuk gjeta vetë ndonjë klasifikim
21 për deklaratat e nxjerra nga ekipi i Gucatit.

22 Dhe vë re, gjithashtu, se nuk i kërkohen masa mbrojtëse,
23 pra, udhëzimi që kërkoj është në qoftë se mund t'i referohem
24 pjesëve të caktuara të deklaratave të dëshmitarëve të
25 Mbrojtjes në seancë të hapur, apo kërkoni që të kaloj në

1 seancë private.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti Rees.

3 Z. REES: [Përkthim] Gjatë gjithë kohës kemi inkurajuar
4 dhe kemi nxitur transparencë dhe seanca të hapura. Ne nuk kemi
5 problem që këto çështje të trajtohen publikisht.

6 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe ne.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] I

8 përgjigjet kjo pyetjes suaj, zoti Pace?

9 Z. PACE: [Përkthim] Po. E vlerësoj sqarimin e Mbrojtjes
10 në lidhje me këtë çështje.

11 Siç po thosha, një nga deklaratat e nxjerra të
12 dëshmitarit e bëjnë të parëndësishme, pra, deklaratën e
13 Mbrojtjes.

14 Unë do të përmend disa shembuj. Së pari do të trajtoj
15 deklaratën e W151 [siç u përkthye]. Deklarata nuk duket se ka
16 ERN, por gjendet në faqet 11 deri 26, të Shtojcës 2, të
17 parashtrimit F461.

18 Deklarata thotë shprehimisht se përmban një pjesë të
19 dëshmisë që ky dëshmitar do t'i jepte Parlamentit të Kosovës.
20 DHSK-ja nuk është Parlamenti i Kosovës dhe Trupi Gjykes nuk
21 lidhet me çështje të cilat i trajton parlamenti. Dhomat e
22 Specializuara të Kosovës-ja është një institucion gjyqësor dhe
23 ky Trup Gjykes trajton një çështje konkrete kur dy persona
24 akuzohen për kryerjen e disa krimeve. Kjo çështje dhe kjo
25 sallë gjyqi nuk është një forum zëvendësues i dikujt që të

1 shprehë shqetësimet e tij.

2 Deklaratat e këtij dëshmitari përbëhen nga ankesa,
3 kritika dhe delegime lidhur me EULEX-in, që është një
4 institucion i ndryshëm nga ky që jemi sot këtu. Deklarata nuk
5 ka asnjë lidhje me këtë çështje.

6 Në 26 faqet e saj dhe 126 paragrafët, deklarata përmend
7 vetë DHSK-në, ZPS-në apo të akuzuarit vetëm kur dëshmitari i
8 jep akuza të pabaza dhe mendimet e tij lidhur me këto
9 institucione dhe kjo bëhet në 10 nga 125 paragrafët. Opinione
10 nga joekspertë që nuk bazohen në fakte, nuk mund të ndihmojnë
11 Trupin Gjykses në këtë çështje.

12 Po ashtu konsiderata të ngjashme vlejné edhe për
13 dëshmitarin DW1250 prej 117 paragrafë, 29 faqe, argumentet
14 janë të ngjashme.

15 Shembulli i fundit që dua të jap, që lidhet me
16 pamundësinë e këtij dëshmitari të Mbrojtjes për të ndihmuar
17 Trupin Gjykses lidhet me DW2146. Në deklaratën e tij që është
18 DGH0181, dëshmitari thotë që nuk ka qenë fare në vend kur kanë
19 ndodhur këto çështje dhe e pranon konkretisht se nuk ka
20 njohuri apo kompetencë të trajtojë ndonjë hetim të zhvilluar
21 nga ZPS-ja lidhur me këtë ngjarje.

22 Ai ofron ato që thotë, po citoj, "opinione personale" për
23 mënyrën sesi ZPS-ja e ka kryer kryerjen dhe sekuestrimin, të
24 dyja opinione të papërshtatshme dhe pa asnjë rëndësi lidhur me
25 akuzat.

1 Gjithashtu dua të trajtoj, po në qoftë se mendoni se
2 duhet ta trajtoj më vonë, mund ta bëj këtë. Në qoftë se e
3 mendoni kështu, lidhur me çdo dëshmitar në vend që të japin
4 përmbledhje të fakteve për të cilat dëshmitarët do të
5 dëshmojnë sipas rregullit 119(2)(a)(IV) Mbrojtja thjesht i
6 referohet këtyre dëshmitarëve apo deklaratave.

7 Që do të thotë që asnjë [nga] çështjet e adresuara në
8 secilin prej këtyre dëshmitarëve të mos ngrihet në pyetjet e
9 drejtpërdrejta.

10 Dhe kur të kërkohet pranimi i këtyre, pranimi i të
11 gjithave me përjashtim të një deklaratë, në rastin e
12 Dëshmitarit 192 [sipas përkthimit], ne kemi parashikuar që 45
13 minuta deri në një orë t'i dedikohen pyetjeve të një
14 dëshmitari.

15 Pra, pyetja që kemi ne është që dëshmitarët të dinë, --
16 nëse dëshmitarët do t'u përmbahen atyre që lidhen me
17 deklaratat që kanë dhënë apo jo?

18 Pra, çështja është që nuk mund të flasësh për çështje që
19 dalin nga deklaratat. Në këtë rast duhet njoftuar pala tjetër
20 përmes një përmbledhjeje të çështjeve që do të adresojnë, gjë
21 që ne nuk na është dhënë. Në qoftë se Mbrojtja do t'ju
22 përmbahet vetëm pyetjeve të drejtpërdrejta lidhur me
23 deklaratat, mbase nuk kërkohet një përmbledhje e tillë edhe
24 pse teknikisht si mbase rregullave të Rregullores kërkohet.

25 Një pikë e fundit është në lidhje me provat materiale që

1 gjithashtu është pjesë e kësaj pike të agjendës.

2 Lidhur me listën e dëshmitarëve të Gucatit, e dimë që
3 disa pika të kësaj liste nuk kanë rëndësi apo nuk lidhen me
4 dëshmitarin që do të thërrasë Mbrojtja.

5 Në interes të shpejtësisë së procedurave duam të dimë
6 nëse Mbrojtja synon të kërkojë apo të parashtrojë ndonjë
7 parashtrim nga pozita e tyre.

8 E dimë që ju e përmendët gjithashtu çështjen që ne
9 ngritëm dje me Njësinë e Administrimit të Gjykatës. Mund ta
10 trajtoj në seancë private tani apo më vonë, por nuk kemi asgjë
11 për të shtuar, përveç atyre që kemi parashtruar në emailin
12 tonë ku vëmë në dukje nevojën e redaktimit, më duket të dy
13 fjalëve.

14 Në qoftë se s'keni më pyetje për këtë çështje apo nuk
15 mendoni se duhet të vazhdojmë më tej, këto ishin parashtrimet
16 tona.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk kemi
18 nevojë që të trajtojmë në këtë moment.

19 Zoti Rees, dëshironi t'u përgjigjeni çështjeve që u
20 ngritën sidomos çështjes së deklaratave të dëshmitarëve dhe
21 tejkalimit të tyre dhe për mocionet nga tavolinat tuaja.

22 Z. REES: [Përkthim] Së pari, Mbrojtja e zotit Haradinaj
23 nuk do të bëjë pyetje të drejtpërdrejta të dëshmitarëve që do
24 të thërrasim dhe nuk e dimë nga e nxori zoti Pace atë që tha.

25 Lidhur me dëshmitarët 1251, 1250 dhe 1246, që i përmendi

1 zoti Pace nuk janë në listën tonë, kështu që këtë do t'ia lë
2 Cadman t'a trajtojë. Por, në përgjithësi, ne e mbështesim
3 ekipin e zotit Haradinaj lidhur me dëshmitarët e tyre. Por
4 është lista e tyre e dëshmitarëve dhe është çështje që e
5 paraqesin ata.

6 Dhe e unë e përmenda shpejt e shpejt edhe sepse është
7 përmendur edhe pse mbase nuk e kemi prekur. Neve e
8 kundërshtojmë çdo sugjerim se thirrja e dëshmitarëve si pjesë
9 e çështjes së zotit Haradinaj të ndërfitet përpara se të
10 përfundojë çështja e zotit Gucati. E kundërshtojmë këtë
11 propozim. Ne duam dhe mendojmë se është e drejta jonë që së
12 pari të thërresim zotin Gucati në Mbrojtje të vet dhe pastaj
13 të përfundojmë çështjen e zoti Gucati, përpara sesa të bëjmë
14 ndonjë lëvizje lidhur me çështjen e Mbrojtjes së zotit
15 Haradinaj.

16 I kemi nxjerrë të gjitha deklaratat e dëshmitarëve të
17 hollësishme, të çdo dëshmitari që propozojmë të thërrasim. Nuk
18 kemi nevojë dhe nuk marrim mësim për nxjerrje materiali
19 sidomos lidhur me çështjen e nxjerrjes paraprake të listës së
20 dëshmitarëve nga Prokuroria.

21 Në deklaratat tona të dëshmitarëve kemi parashtruar
22 çështjet për të cilat një dëshmitar synohet që të japë dëshmi.
23 Në qoftë se do të dalë ndonjë çështje shtesë që kërkojnë
24 nxjerrje të mëtejshme, do ta bëjmë një nxjerrje të tillë. Por
25 grupi i materialeve që kemi nxjerrë përmban me hollësi

1 deklaratat e dëshmitarëve dhe objektin e çështjes së Mbrojtjes
2 së zotit Gucati që do të paraqitet përmes dëshmitarëve të
3 kësaj liste.

4 Lidhur me kohët që ne propozojmë për pyetjet e
5 drejtpërdrejta, ne synojmë që ta pyesim zotin Gucati përmes
6 dëshmisë së tij me hollësi. Për sa i takon dëshmitarëve të
7 tjerë do të bëjmë siç bëjmë në rastin e zotit Gucati por do të
8 përdorim më shumë dispozitat e Rregullores, por duke i pyetur
9 dëshmitarët të konfirmojnë ato që kanë thënë në deklaratat e
10 tyre dhe t'i paraqesim dëshmitarët aty për pyetje nga pala
11 tjetër.

12 Mbase mund të bëjmë pyetje shtesë në qoftë se është e
13 nevojshme për të vënë në dukje më shumë disa aspekte të
14 caktuara. Ne mendojmë që duke e lënë dëshmitarin që të
15 kundërpyetet nga Prokuroria. Ne mendojmë që kjo është mënyra
16 sesi duhet vepruar me qëllim që procedura të zhvillohet në
17 mënyrë efikase dhe të shpejtë.

18 Lidhur me ndonjë fjali të caktuar që mund të përmbahet në
19 deklaratat e dëshmitarëve, të cilat Prokuroria i kundërshton,
20 qëndrimi ynë është ky. Njeriu nuk ka nevojë që t'i shikojë
21 këto deklarata fiye për fiye për të gjetur ndonjë fjali të
22 cilën Prokuroria mund ta kundërshtojë.

23 Juve jeni Trup Gjykues profesionist dhe ju e dini që një
24 dëshmitar thirret, dëshmon dhe pastaj juve i jepni peshën në
25 momentin e duhur kësaj dëshmie.

1 I vetmi dëshmitar për të cilin ka kundërshtim, në
2 kuptimin e heqjes nga lista të tij, ne e kuptojmë se
3 kundërshtimi lidhet me deklaratën e Dëshmitarit 1248. Është
4 zoti Bowden i cili është i pranishëm në Gjykatë, sigurisht.

5 Juve ju kujtohet, se ne u lejuam si mënyrë e përshtatshme
6 pyetjesh, që në rastin e dëshmitares Pumper dhe Halil Berisha,
7 dëshmitë ishin të disponueshme publikisht. Dëshmitari nuk
8 pranoi që të konfirmonte atë që i thamë.

9 Zoti Bowden konfirmon se, në fakt, ekzistojnë, janë këto
10 uebsajte, ekzistojnë. Pra, mbase çështja mund të trajtohet si
11 fakt i pranuar. Por ne na lejuat që të bënim pyetjet dhe na u
12 duk se e bëmë punën tonë. Por mbase mund ta trajtojmë edhe
13 njëherë këtë çështje.

14 Sa i takon listës së provave materiale të propozuara.
15 Asnjëra prej tyre nuk është dorëzuar deri tani për sa i takon
16 pranueshmërisë së tyre. Ne e njohim inkurajimin nga Trupi
17 Gjykues në këtë fazë që të përdoren mocionet e provave të
18 drejtuara në mënyrë të drejtpërdrejtë për Panelin, por masa në
19 të cilën lista e provave të mundshme, që mund të jetë pjesë e
20 këtij parashtrimi të drejtpërdrejtë për Panelin, do të duhet
21 që të përcaktohet. Megjithatë, në momentin kur të kemi një
22 përgjigje do t'i drejtohem Trupit Gjykues.

23 Në qoftë se nuk ka ndonjë pyetje tjetër apo ndonjë
24 çështje tjetër për t'u mbuluar mendoj se iu përgjigjem
25 kërkesave në emër të ekipit Gucati deri tani.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
2 Cadman, fjala për ju.

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Do të mundohem që të mos përsërisë
4 gjërat të cilat sapo u thanë nga zoti Cadman [siç u përkthye],
5 por thjeshtë që dua të them që mbështes atë çfarë parashtroi
6 ai në pozicionin e tij. Në veçanti, dua të sqaroj diçka, nuk
7 është synimi i ekipit të Haradinajt që të drejtojnë apo t'u
8 bëjë pyetje dëshmitarëve të cilët janë pjesë e listës së
9 dëshmitarëve të zotit Rees.

10 Në qoftë se do të ketë pyetje të tjera shtesë që duhet që
11 t'ju bëjmë këtyre dëshmitarëve në mënyrë që këto pyetje të
12 bëhen nga ana jonë, pra, nga ana e ekipit të Haradinajt këto
13 do të bëhen në përfundim të marrjes së drejtpërdrejtë të
14 pyetjeve nga zoti Rees. Domethënë, nuk do të jem unë personi
15 që do t'i bëj pyetjet kryesore këtyre personave por do të jetë
16 zoti Rees, në fakt, ai që do të marrë në mënyrë të
17 drejtpërdrejtë në pyetje këta persona.

18 Sa i takon kundërshtimeve të dëshmitarëve të cilët janë
19 propozuar, e kam fjalën posaçërisht për tre dëshmitarë të
20 cilët janë pjesë e listës së zotit Haradinaj, më specifikisht
21 le të marrim dëshmitarin 1251 së pari, ne e kemi shprehur
22 qëndrimin tonë se pse këta dëshmitarë janë të rëndësishëm për
23 të paraqitur Mbrojtjen e zotit Haradinaj dhe e kemi theksuar
24 elementin e interesit publik. Dhe vazhdojmë t'i qëndrojmë të
25 njëjtë qëndrim edhe sot.

1 Sigurisht ZPS-ja ka parashtruar kundërshtimet e veta,
2 këtyre kundërshtimeve ne ju jemi përgjigjur. Nuk mendoj që
3 duhet të vijojmë me hollësi t'i japim kundërpërgjigjet tani
4 pasi këtë gjë e kemi bërë. Megjithatë duam të themi edhe një
5 herë që deklaratat e këtyre personave janë të rëndësishme sa i
6 takon përcaktimit të interesit publik. Dhe pozicioni ynë është
7 që, le të themi, kuadri, le të themi, korniza mendore e zotit
8 Haradinaj përcaktohet në periudhën kohore të specifikuar. Dhe
9 kjo në fakt parashtrohet dhe në përmbledhjen që i kemi
10 dorëzuar në emër të tij dhe një version i plotë do t'i
11 dorëzohet Trupit Gjykues nesër.

12 Neve mbajmë pozicionin që këta dëshmitarë janë shumë të
13 rëndësishëm sa i takon përcaktimit të interesit publik.

14 Sa i takon dëshmitarit 1246 ose më saktë DW1246 edhe pse
15 ky dëshmitar është pjesë e listës së dëshmitarëve të cilët
16 kërkohen prej nesh. Ky dëshmitar është i rëndësishëm sepse
17 duhet që të nxjerrim në qoftë se policia kosovare është
18 udhëzuar për të kryer hetime ose është penguar për të kryer
19 hetime. Kështu që është shumë e qartë se cili ishte pozicioni
20 nga ky dëshmitar sa i takon ZPS-së dhe sa i takon udhëzimeve
21 që i ka dhënë ZPS-ja Policisë së Kosovës. Personi në fjalë ka
22 qenë një person në nivel të lartë në policinë kosovare dhe
23 fakti që personi nuk ka qenë në vend në momentin e nxjerrjes
24 së informacionit nuk cek provat të cilat ai mund të paraqesë.
25 Ai, si zyrtar i lartë i policisë, mund të parashtrojë këtu dhe

1 mund të thotë se cilat janë udhëzimet të cilat i janë dhënë
2 Policisë së Kosovës dhe oficerëve të tjerë të cilët kanë qenë
3 nën drejtimin e tij. Nuk është se do shkojmë më tej lidhur me
4 hollësitë të cilat ai do të japë përpara Trupit Gjykses, por
5 ky është pozicioni ynë sa i takon këtij dëshmitari.

6 Lidhur me kohën ose me kuadret kohore të cilat janë
7 përcaktuar. Ne kemi pozicionin, që sapo u parashtrua nga zoti
8 Rees, pra, do na duhet që të kalojmë shumë shkurtimisht
9 deklaratat të cilat na janë dhënë. Mund të ketë, le të themi,
10 pyetje shtesë të cilat do të dua që bëjmë, megjithatë,
11 parashikimi ynë është që të mos e tejkalojmë afatin kohor që e
12 kemi parashtruar në dosjen 119.

13 E vetmja pyetje është mbase nënvlerësimi i kohës që
14 është caktuar për provën për dëshminë që do të jepet për zotin
15 Haradinaj. Mendoj që në dokumentin 119 është përcaktuar për dy
16 apo tre orë. Mendoj që do të ishte shumë ambicioze të themi që
17 kjo dëshmi të mund të përfundojë për dy apo tre orë. Mendojmë
18 që ndoshta dëshmia e zotit Haradinaj do të kërkojë një ditë të
19 plotë.

20 Dhe këtë parashtrim do ta dërgojmë sërish në parashtrimin
21 e ndryshuar. Sa i takon provave dhe ndoshta po dal përpara
22 kohe, megjithatë lidhur me provat materiale që do të dorëzohen
23 nga Mbrojtja e zotit Haradinaj, ne pa diskutim që do të
24 miratojmë listën e provave materiale të cilat janë dorëzuar
25 nga Mbrojtja e zotit Gucati. Ndërkohë që provat shtesë kanë të

1 bëjnë kryesisht me dy dëshmitarët ekspertë dhe raportet të
2 cilat janë përmendur në raportet e tyre të ekspertëve.
3 Megjithatë, kjo listë e provave materiale mund të dorëzohet
4 deri në fund të ditës së sotme.

5 Nuk e di në qoftë se të nderuar Gjykatës, doni që unë të
6 cek ndonjë gjë tjetër shtesë për momentin apo mjafton kaq.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

8 Faleminderit, zoti Cadman.

9 Trupi Gjykses do të japë një urdhër gojor sa i takon
10 klasifikimit të listës së provave. Ndërkohë vendimi lidhur me
11 dëshmitarët e Mbrojtjes do të nxirret nesër, ndërkohë që një
12 përmbledhje gojore do të jepet sot gjatë kësaj seance.

13 Zoti Pace, fjala për ju.

14 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit për fjalën. Dua të ngre
15 dy-tre çështje që kanë të bëjnë me parashtrimin e Mbrojtjes.

16 E para ka të bëjë me atë çfarë tha zoti Gucati, Mbrojtja
17 e zoti Gucati, që lidhen me parashikimet e rregullit 154.

18 Ne kemi qëndrimin që rregulli 154 nuk duhet që të
19 përdoret për të shmangur kërkesat e rregullit 138 dhe as nuk
20 duhet të shmangë edhe pjesën e dhënies së dëshmisë së
21 dëshmitarëve *viva voce*. Pra, në qoftë se, flasim për
22 relevancën apo rëndësinë e dëshmitarëve ne e kundërshtojmë
23 këtë gjë dhe të njëjtin pozicion e mbajmë edhe sot dhe kjo
24 duhet të shikohet nën dritën e rregullit 154. Ne nuk po themi
25 që e gjithë deklarata duhet që të përfshijë një opinion të

1 rëndësishëm, megjithatë duhet që kjo deklaratë të përfshijë
2 parakushtet e parashikuar sipas rregullit 154.

3 Sa i takon Dëshmitarit 1248, ne vazhdojmë që të mbajmë të
4 njëjtin qëndrim, nuk e dimë se cila është rëndësia e
5 informacionit që do të japë ky person për Trupin Gjykses. Në
6 qoftë se Trupi Gjykses mendon që provat që do të jepen nga ky
7 person janë të qenësishme mendojmë që pranueshmëria e provave
8 të mund të shikohet nën dritën e rregullit 153. Pra, ne po
9 ofrojmë këtë si alternativë.

10 Ndërkohë që gjëja e fundit që dua të cek, shumë
11 shkurtimisht, është që duket sikur Mbrojtja tani do të
12 parashtrojë prova të drejtpërdrejta përpara Trupin Gjykses,
13 kështu që do të doja t'i kërkoja Trupit Gjykses që t'i
14 kërkonte Mbrojtjes që të përcaktonte afatet kohore. Dhe është
15 diçka që do të kërkojnë, le të themi, afatet kohore dhe nuk
16 duam që, le të themi, të zgjaten procedurat për shkak të
17 mosinformimit në kohë apo për shkak të mosdijes se kur këto
18 prova të drejtpërdrejta do t'i jepen Trupit Gjykses.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
20 Cadman, shikoj që je në këmbë.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Ka edhe një tjetër çështje që
22 doja ta trajtoja pak më parë, e kam fjalën për kohën e
23 ekspertëve tanë. Kemi qenë në kontakt me ZMD-në dhe eksperti,
24 aktualisht, domethënë banon në Australi dhe siç dihet, do jetë
25 një sfidë e vërtetë sa i takon organizimit të dhënies së

1 dëshmisë së tij.

2 Lidhur me kohën, ai nuk do të ketë mundësi që të japë
3 dëshminë e tij përpara datës 17. Data 17 është data e parë kur
4 ai është i disponueshëm për të dhënë dëshminë përpara Trupit
5 Gjykues. Pra, sa më shpejt ta dimë në qoftë se ekspertët do të
6 thërriten për të dhënë dëshminë apo miratohet prania e tij aq
7 më mirë do të jetë sepse do të mund t'i japim atij njoftim
8 paraprak sa i takon organizimit të agjendës së vet.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

10 Faleminderit, zoti Cadman. E morëm shënim këtë çështje, do ta
11 trajtojmë atë.

12 Le të vazhdojmë me temën tjetër. Tema ka të bëjë me
13 marrjen në pyetje nga pala kundërshtare. Trupi Gjykues vëren
14 se parashtimi i Mbrojtjes së zotit Gucati [sipas përkthimit]
15 nuk synon të pyesë dëshmitarët e Gucatit. Gjithashtu Trupi
16 Gjykues vëren sfidat pezull të ZPS-së, megjithatë, pyet që
17 këto vlerësime në rast se këto kundërshtime rrëzohen.

18 Së pari, zoti Rees, do të doja t'ju pyesja sa i takon
19 dëshmitarëve të zotit Haradinaj, a është vlerësimi juaj i
20 ngjashëm me vlerësimin që sapo na u dha nga zoti Cadman?

21 Z. REES: [Përkthim] Lidhur me Dëshmitarin 1246, mendoj që
22 do të kem disa pyetje të shkurtra lidhur me të, por nuk mendoj
23 që do të gjata sesa 20 minuta. Sa i takon dëshmitarëve të
24 tjerë të mbetur, pozicioni apo qëndrimi im është që pyetjet
25 nga unë do të lidhen vetëm me çështje shtesë të cilat mbase

1 mund të dalin nga marrja e drejtpërdrejtë në pyetje nga zoti
2 Cadman i këtij dëshmitari.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

4 Faleminderit, zoti Rees.

5 Zoti Prokuror, cili është vlerësimi mesatar i juaji,
6 paraprak i juaji, sa i takon marrjes në pyetje të dëshmitarëve
7 të Mbrojtjes?

8 Z. PACE: [Përkthim] Për marrjen në pyetje të dëshmitarëve
9 të zotit Gucati ne parashikojmë 10 orë. Megjithatë do t'i
10 futem më shumë hollësive për pak, për t'ju shpjeguar më tepër
11 se çfarë synojmë të bëjmë.

12 Ndërkohë që sa i takon marrjes në pyetje të Dëshmitarit
13 1214, 1242, 1243, 1244, 1245 si dhe 1247, neve vlerësojmë dy
14 orë për secilin prej këtyre dëshmitarëve. Për dëshmitarin
15 1248, sigurisht kjo varet nga mocioni që kemi parashtruar në
16 kuptimin që në qoftë se Trupi Gjykes do pranojë provën e tij,
17 kjo provë sipas qëndrimin tonë do të duhet që të pranohet mbi
18 bazën e parashkrimeve në rregullin 153.

19 Sa i takon dëshmisë së zotit Haradinaj, e kemi marrë sot
20 në mëngjes përmbledhjen e zotit Haradinaj. Nuk kemi pasur
21 mundësi që ta lexojmë këtë dokument deri tani. Ne e kuptojmë
22 që afati kohor për deklaratën e plotë parashikohet deri nesër,
23 ose të paktën këtë ka marrë përsipër Mbrojtja për zotin
24 Haradinaj për të bërë.

25 Megjithatë, duam që të kemi disa hollësi të tjera sa i

1 takon mënyrës së bërjes së dëshmisë nga zoti Haradinaj. Dhe
2 mbetet në parashtrimet e Mbrojtjes e përcaktuar që kjo do të
3 jetë një dëshmi sipas rregullit 154. Kur dhe si do të jepet
4 një deklaratë të tillë, mendojmë që duhet të jetë nën
5 parashikimet e rregullit 154, sepse, sigurisht, kjo do të ketë
6 ndikim mbi vlerësimet e kohës që do të na duhet neve për të
7 bërë pyetjen për Mbrojtjen e zotit Haradinaj.

8 Ndërkohë që ne po flasim për përmbledhjen e zotit
9 Haradinaj, dua të them që është shumë e rëndësishme që ne të
10 marrim informacion të mëtejshëm sa më parë të jetë e mundur
11 dhe në mënyrë që të kemi mundësinë e duhur për të bërë
12 përgatitjet përkatëse.

13 Do të vazhdojmë me vlerësimet e dëshmitarëve të tjerë.
14 Për 1254-n, ne vlerësojmë që ta marrim në pyetje na duhet
15 katër orë. Ndërkohë për dëshmitarin 1246, 1250, 1251 dhe 1252,
16 në qoftë se autorizohen që të japin dëshmi, që ne mendojmë që
17 nuk duhen të lejohen që të japin dëshmi, megjithatë, në qoftë
18 se ato pranohen ne do të na duhen dy orë për t'i marrë në
19 pyetje ata. Por, për dëshmitarin e fundit D1253 në qoftë se
20 pranohet të japë dëshmi, sërish qëndrimi ynë është që të mos
21 pranohet të japë dëshmi, por, megjithatë, në qoftë se ju
22 vendosni ndryshe, neve parashikojmë që të përdorim katër orë
23 për të marrë këtë person në pyetje.

24 Këto janë vlerësime të përafërta. Në veçanti, ne duam të
25 parashikojmë që ne nuk kemi marrë njoftim për provat

1 materiale. Dhe duam disa sqarime për këtë gjë. Ndoshta s'kemi
2 marrë njoftime sepse nuk do të përdoret asnjë provë tjetër
3 përveç deklaratave. Megjithatë do të duam që kjo gjë të
4 sqarohet.

5 Sa i takon marrjes në pyetje të të akuzuarve, ne thamë që
6 na duhen dhjetë orë, megjithatë do të duhet që të shohim sesa
7 kohë do t'i jepet zotit Haradinaj për të dhënë dëshminë e tij.
8 Megjithatë, koha që do të kërkojmë neve për të bërë pyetje nga
9 ana jonë do të lidhet me specifikat apo hollësitë që do të
10 jepen në pyetjet që do t'i bëhen personit në fjalë.

11 Këto janë parashtrimet që kemi për momentin, nuk është se
12 kemi ndonjë koment tjetër shtesë për të dhënë për momentin.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

14 Faleminderit, zoti Pace.

15 Atëherë mund të vijojmë me temën tjetër. Tema tjetër ka
16 të bëjë me parashtrimet e tjera shtesë për elementet e veprave
17 penale dhe mënyrave të përgjegjësisë penale.

18 Përpara sesa t'i jap fjalën Gjykatësit Barte, që ka disa
19 pyetje, dua të them që Trupi Gjykues i ngre këto çështje sepse
20 ato nuk kanë dalë siç duhet në konferencën për përgatitjen e
21 çështjes për Mbrojtjen. Këto janë sqarime që neve kërkojmë për
22 sa i takon elementëve të ligjit dhe janë parashtrime të cilat
23 bien nën rregullin 130.

24 Gjykatësi Barte, fjala për juve.

25 GJYKATËSI BARTE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi

1 Smith.

2 Së pari, palët a mund të sqarojnë në qoftë se ka ndonjë
3 kërkesë specifike për synimin nën pikën 4, që është hakmarrja;
4 dhe mund ta pyesin ZPS-në që të na thotë sesi ky element
5 lidhet me këtë përkufizim, pra, kjo pikë në Aktpadi lidhet me
6 këtë përkufizim.

7 Prokuror, fjala për juve.

8 Z. PACE: [Përkthim] Sa i takon ligjit të zbatueshëm dhe
9 sa i takon elementeve të krimit dhe të mënyrës së
10 përgjegjësisë penale, neve në përgjithësi mbështetemi në
11 vendimin për konfirmimin e Aktakuzës në parashtrimet e
12 mëparshme.

13 Sa i takon pyetjes specifike të drejtuar prej jush. Neve
14 mbështetemi, në veçanti, në paragrafin 52 dhe 57 të vendimit
15 për konfirmimin e Aktakuzës. Dhe parashtrimi ynë që synimi
16 specifik që kërkohet nën pikën 4 është që është hakmarrja dhe
17 kjo përcaktohet me saktësi në nenin 388, paragrafi 1.

18 Tani dua që t'i referohem paragrafit 65 dhe dua të sqaroj
19 që subjektet e hakmarrjes janë ato persona të cilët
20 identifikohen "dëshmitarë" dhe kjo përcaktohet në nenin 388.
21 Dhe përdor thonjëzat "si dëshmitar", sepse ne e dinë që
22 dëshmitar është një term specifik dhe duam që ta shikojmë atë
23 nënë kuadrin e kësaj çështje.

24 Sa i takon faktit sesi provat mbështesin këtë synim
25 specifik ne mendojmë që është mirë që t'i referohemi një

1 kategorie provash që janë deklaratat e dhëna nga të akuzuarit,
2 siç janë reflektuar në shumë dalje apo shfaqje të tyre publike
3 në media apo konferenca për shtyp, ku ata demonstrojnë që do
4 të hakmerren ndaj personave të cilët kanë dhënë informacion
5 për të bashkëpunuar me ZPS-në dhe këtë, në fakt, e përcaktojnë
6 apo e bëjnë në mënyra të ndryshëm gjë të cilën ne e kemi
7 parashtruar në dosjen paraprake. Dhe në veçanti, kjo
8 parashikohet në parashikimet që kemi dhënë sipas rregullit
9 130.

10 Pra, po ashtu dhe mënyra e hakmarrjes është përmes
11 formave të ndryshme. Përmes daljes së tyre në publik, në media
12 dhe këto janë masa të cilat janë ndërmarrë në mënyrë që të
13 hakmerren ndaj njerëzve. Ndërkohë nuk është e nevojshme që të
14 japim akte të tjera të drejtpërdrejta apo specifike nga ato të
15 cilat i kemi parashtruar në provat tona dhe mendojmë që ky
16 qëndrimi jonë apo parashtrimet tona janë shumë të qarta sa i
17 takon kësaj çështjeje.

18 GJYKATËSI BARTE: [Përkthim] Faleminderit, Prokuror.

19 Zoti Rees, keni ndonjë koment lidhur me këtë?

20 Z. REES: [Përkthim] Nuk do të përgjigjem për parashtrimet
21 që kanë të bëjnë me provat që sapo bëri zoti Pace. Do ta
22 rezervojmë këtë gjë, le të themi, në parashtrimin përfundimtar
23 dhe në deklaratën përmbyllëse.

24 Sa i takon pyetjes specifike, ZPS-ja duhet që të
25 identifikojë individët të cilët kanë qenë objekt i hakmarrjes.

1 Dhe nuk jam i sigurt që më duhet të shkojmë më shumë sesa
2 kaq, apo ta specifikoj pak më shumë sesa kaq qëndrimin tim për
3 momentin.

4 GJYKATËSI BARTE: [Përkthim] Faleminderit, zoti Rees.

5 Zoti Cadman.

6 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar, faleminderit dhe dua të
7 them që mbështes plotësisht atë çfarë u tha deri tani edhe atë
8 çfarë kemi parashtruar në parashtrimet e mëparshme lidhur me
9 elementet e krimit dhe mënyrat e përgjegjësisë penale.

10 GJYKATËSI BARTE: [Përkthim] Pyetja e dytë është: Në qoftë
11 se palët mund të qartësojnë pozicionin e tyre lidhur me atë
12 çfarë kërkohet në pikën 6, që masat mbrojtëse ishin ende të
13 vlefshme dhe në fuqi në kohën kur janë kryer veprat penale,
14 ose veprat e pretenduara penale, e kam fjalën në shtator të
15 vitit 2020 dhe specifikisht e kam fjalën për hakmarrjen, për
16 masat mbrojtëse të cilat janë dhënë nga Gjykata dhe jo nga
17 gjykata të tjera.

18 Z. PACE: [Përkthim] Sa i takon këtyre pikave, ZPS-ja
19 mbështetet në paragrafët 34 dhe 50 të vendimit për Konfirmimin
20 e Aktakuzës. Në veçanti, në përkufizimin për informacionin e
21 mbrojtur nën pikën 5 dhe në paragrafin 37; të personave të
22 mbrojtur, për pikën 6, në paragrafin 44 japin parashtrimet
23 përkatëse. Kjo tregon që këto janë nocione shumë të gjëra.

24 Në veçanti, nenet 392(2) dhe (3) nuk kërkojnë
25 specifikisht masa specifike apo formale mbrojtëse ose urdhra

1 mbrojtje si të tilla. Kështu që masat mbrojtëse të dhëna nga
2 kjo Gjykatë apo gjykata të tjera janë një ndër mënyrat që
3 personat të mund të cilësohen si të persona të mbrojtur.
4 Megjithatë edhe në qoftë se nuk do të ekzistonin masa të
5 tilla, dëshmitarët në këtë çështje do të ishin të mbrojtur në
6 kuptimin e ligjit sepse përkufizimi i dhënë dhe përkufizimi që
7 ne jemi, është përkufizimi i duhur.

8 Ajo çfarë kërkohet është që të jepet, domethënë, që të
9 identifikohet dhënia e informacionit të paautorizuar për
10 identitetin apo të dhënat personale për persona të caktuar të
11 cilët janë të përfshirë në procedura penale. Kështu që
12 formulimi mbështet atë çfarë thamë ne dhe atë çfarë tha edhe
13 Gjykatësi i Procedurës Paraprake, që nuk kërkohet një vendim
14 specifik i Gjykatës.

15 Megjithatë, do të dua të bëj disa komente lidhur me
16 vendimin e Gjykatës.

17 Trupi Gjykues ka dhënë prova të rëndësishme të cilat
18 tregojnë që DHSK-ja, pra, masat mbrojtëse të cilat janë dhënë
19 nga DHSK-ja nuk janë ndryshuar. Këto janë Çështjet 04 dhe 05.
20 Njëra prej të cilave është në fazën paragjyqësore dhe tjetra
21 është në gjykim. Po ashtu, Paneli ka pranuar prova që kërkesat
22 e ZPS-së për masa mbrojtëse janë pezull përpara Gjykatësit të
23 Procedurës Paraprake në procedura të tjera. Këtu i referohem
24 specifikisht provave P151, P152, P154. Kjo e fundit është një
25 tjetër tregues se masa formale mbrojtjeje janë miratuar.

1 Sa i takon masave përkatëse mbrojtëse të urdhëruara nga
2 Gjykatat kosovare. ZPS-ja nuk ka qenë në dijeni të masave të
3 tilla në momentin kur janë ngritur paditë. Në të kundërtën nuk
4 do kishim vepruar kështu siç kemi vepruar. Dhe nga ana tjetër
5 ne kemi provë që këto masa nuk janë ndryshuar nën prova
6 specifike dhe ZPS-ja synon që të mbështetet në parashtrimet
7 tona, parashtrime të cilat i kemi bërë më përpara dhe
8 parashtrimet që sapo bëmë lidhur me këtë çështje.

9 GJYKATËSI BARTE: [Përkthim] Faleminderit.

10 Zoti Rees.

11 Z. REES: [Përkthim] Sërish nuk do trajtoj provat që sapo
12 ka dëgjuar Trupi Gjykues se do ta rezervojmë këtë pozicion më
13 vonë në këtë proces gjyqësor në parashtrimet përmbyllëse.
14 Sigurisht, do ta injoroj, do ta anashkaloj përpjekjen e zotit
15 Pace për të dhënë prova të tjera shtesë lidhur me këtë pikë.

16 Sa i takon pyetjes specifike që bëtë, në qoftë se
17 kërkohet provë dhe në qoftë se klasifikimi konfidencial
18 ose/dhe masat mbrojtëse janë të vlefshëm dhe janë në forcë, ne
19 jemi shprehur lidhur me këtë dhe i qëndrojmë pozicionit tonë,
20 e kam fjalën për pozicionin që ne kemi dhënë më parë dhe që do
21 ta shtjellojmë, do ta japim edhe më tej në deklaratën
22 përmbyllëse.

23 GJYKATËSI BARTE: [Përkthim] Zoti Cadman.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Sa i takon provave kemi të njëjtin
25 pozicion dhe neve. Për sa i takon parashtrimin F00342, të

1 parashtrimit të zotit Haradinaj, ky është dokumenti në të
2 cilin neve e trajtojmë specifikisht pyetjen tuaj dhe ku mund
3 të merrni përgjigjet përkatëse.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Një pyetje
5 tjetër. Nuk është se ka të bëjë me këtë temë, por thjesht për
6 çështje planifikimi.

7 Për momentin, a synoni që zoti Haradinaj të japë dëshminë
8 e tij kryesisht me gojë apo përmes parashtrimit të një
9 dokumenti shkresor?

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, ai do ta japë me gojë dëshminë
11 e tij.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
13 Faleminderit.

14 Tani do kalojmë me temën tjetër që ka të bëjë me
15 aplikimin për videolidhje. Trupi Gjykses vëren se dëshmitari
16 lidhur me të cilin bëhet kërkesa ka të bëjë me kundërshtimin e
17 ZPS-së dhe është Dëshmitari 1253. Trupi Gjykses i kërkon
18 Prokurorisë që të shprehet në qoftë se dëshiron që të bëjë
19 parashtrime të tjera sa i takon aplikimit me videolidhje për
20 këtë dëshmitar.

21 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
22 Lexova shkurtimisht parashtrimet e Zyrës së Administrimit, të
23 cilat janë njoftuar sot në mëngjes. Dhe nga vështrimi i
24 shpejtë që i hodha këtij dokumenti, shoh që kërkesat të cilat
25 janë kërkuar fillimisht për prova për videokonferencë mund të

1 përmbushen.

2 Pra, në qoftë se dëshmia do të ndodhë, megjithëse ju e
3 dini pozicionin tonë që neve jemi kundër dhënies së dëshmisë
4 së këtij dëshmitari, ne nuk jemi kundër gjithsesi lidhjes me
5 videolink të këtij dëshmitari në qoftë se Trupi Gjykses vendos
6 që ta pranojë atë dhe që të japë dëshminë përpara nesh. Pra,
7 ne do të kërkojmë që të ruhet konfidencialiteti i dokumenteve,
8 pra, të ruhen këto dokumente si konfidenciale dhe kërkojmë
9 gjithashtu që pjesa më e madhe e dëshmisë së këtij personi të
10 mund të jepet në sesion privat.

11 Sërish, pra, Zyra e Administrimit, siç e dëgjuam dhe më
12 përpara, i ka bërë të gjitha organizimet e duhura sa i takon
13 lidhjes me videolidhje dhe për momentin nuk kam asgjë tjetër
14 për të shtuar. Faleminderit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Zoti
16 Cadman.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Dua të mbështes atë çfarë u tha
18 nga Prokuroria që Zyra e Administrimit i ka trajtuar çështjet
19 siç duhen trajtuar. Dhe ja dakord gjithashtu dhe për pjesën që
20 mbase dëshmitari duhet që të japë dëshmi në seancë private,
21 megjithatë ka edhe segmente të regjistrimit në video të cilat
22 do të duhet që të jepen, për të mirë të publikut, në seancë të
23 hapur.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
25 Faleminderit, zoti Cadman.

1 Trupi Gjykses do të trajtojë tani disa prej çështjeve të
2 cilat janë mbuluar dje nga palët përmes postës elektronike,
3 emailit.

4 Mbrojtja e zotit Gucati ngre çështjen e vazhdimit të
5 mbajtjes në paraburgim të zoti Gucati dhe po ashtu thotë që
6 duhet të respektohet paragrafi 34 i parashtrimit F390. Trupi
7 Gjykses e mirëpret këtë pyetje dhe dëshiron të japë
8 informacion të mëtejshëm sa i takon hapave pasardhës që do të
9 merren.

10 Trupi Gjykses njofton që Policia e Kosovës ka parashtruar
11 raportin e vet më 25 nëntor 2021 dhe Zyra e Administrimit e ka
12 dorëzuar raportin më 26 nëntor 2021.

13 Trupi Gjykses u informua sot në mëngjes që përkthimi në
14 anglisht i policisë kosovare është gati dhe do të shpërndalet
15 për pak kohë, në qoftë se nuk është shpërndarë tani që jemi në
16 seancë.

17 Trupi Gjykses do të shqyrtojë raportin e policisë dhe do
18 të urdhërojë palët që të komentojnë mbi të dyja raportet në
19 qoftë se dëshirojnë. Dhe në kuadër të afatit dy mujor të
20 rishikimit të mbajtjes në paraburgim, Trupi Gjykses urdhëron
21 ZPS-në që të bëjë parashtrimet e veta sa i takon vazhdimit të
22 mbajtjes në paragjykim. Trupi Gjykses pret të japë një urdhër
23 lidhur me palët ose sot ose të hënën.

24 A ka ndonjë gjë për t'u shtuar nga palët?

25 Prokuroria.

1 Zoti Rees.

2 Zoti Cadman.

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk isha i qartë. Nuk e kuptova u
4 urdhërua ZPS-ja që të jepte përgjigje lidhur me pyetjen e bërë
5 prej jush?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ose deri
7 nesër ose deri të hënën.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Atëherë ZPS-ja duhet të japë
9 parashtrimet e veta deri atëherë?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jo, ne po
11 e urdhërojmë ZPS-në që të japë parashtrimet e veta por afatin
12 apo datën nuk e kemi përcaktuar ende.

13 Për të sqaruar të gjithë, afati kohor kur duhet që të
14 parashtrihen këto parashtrime do të jepet ose nesër ose të
15 hënën.

16 Trupi Gjykses vëren se pyetja e dytë që ngrihet nga
17 Mbrojtja e zoti Gucati që: "ZPS-ja synon që të marrë si
18 dëshmitar për kundërmarrje në pyetje për të trajtuar me
19 nxjerrjen pezull të paketave të cilat kanë arritur në zyrat e
20 OVL së UÇK-së?"

21 Në qoftë se e kuptojmë pyetjen tuaj, e keni fjalën për
22 çështjen pezull që ka të bëjë me dokumentin 202. Trupi Gjykses
23 vëren se nuk është marrë akoma një vendim lidhur me këtë
24 çështje. Për më tepër edhe kur të merret vendimi, urdhri gojor
25 i Panelit, pra, ka thënë që do të duhet që të merren shqyrtime

1 të tjera.

2 Dhe, ndërkohë, Mbrojtja në këtë pikë ka thënë që ZPS-ja,
3 stafi i ZPS-së, të cilët kanë dëshmuar për këtë çështje, pra,
4 mund të merren sërish në pyetje për të sqaruar.

5 Më duket se zoti Rees keni ndonjë element apo sqarim për
6 të bërë lidhur me këtë çështje?

7 Z. REES: [Përkthim] Po. Po kam sqarime për të bërë sa i
8 takon rregullit 102(3), njoftimit që kërkohet sipas këtij
9 rregulli, po gjithashtu edhe dokumenteve që kemi marrë për
10 çështjen e Prokurorisë.

11 Jemi në dijeni të faktit që urdhrat gojorë të cilët janë
12 bërë më përpara për kërkesa për kundërpjetjen e Prokurorisë,
13 për dëshmitarët e Prokurorisë, domethënë, kjo pikë e vënies në
14 lëvizje nuk është se është arritur akoma sepse duhet ende që
15 të bëjmë vlerësimin sipas rregullit 102(3). E di që e kam
16 ngritur më përpara, por dua që ta përsëris edhe njëherë, që
17 mbështetur në nxjerrjen e materialeve që kemi marrë asnjë prej
18 tre dëshmitarëve që ka thirrur ZPS-ja deri tani nuk mund të na
19 ndihmojnë për çështje të cilat janë nxjerrë.

20 Ata, në fakt, e kanë bërë shumë të qartë në momentin kur
21 dhanë provat e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në
22 përgjigje të pyetjeve deri në çfarë mase ato mund të ndihmojnë
23 për çështje që janë nën hetim apo se cili ishte procesi sesi
24 dokumentet arritën tek OVL-ja e UÇK-së.

25 Çështjet na janë bërë të qarta dhe neve besojmë, që është

1 vetëm e drejtë, që në qoftë se -- pra, do të ishte mirë që
2 ZPS-ja të mund të na jepte një emër nën stafin e vet, në
3 mënyrë që ne mund t'i bënim pyetje dhe mund të merrnim
4 përgjigje për sa i takon kësaj çështje, sepse marrja në pyetje
5 e zonjës Pumper, zotit Jukiç apo e dëshmitarit tjetër,
6 domethënë, nuk do të na ndihmojë fare sepse ata nuk janë në
7 pozicion që të na japin informacione të tjera shtesë për të
8 pasur më shumë qartësi për të krijuar pozicionin tonë.

9 Kështu do të donim që të përsërisnim dhe njëherë
10 parashtrimin që ZPS-ja të mund të na jepte emrin e një
11 nëpunësi të vet që të ishte në gjendje t'i jepte përgjigje
12 pyetjeve tona për procesin sesi dokumentacioni ka arritur në
13 OVL-në e UÇK-së. Pra, nuk është e rëndësishme që të na japë
14 informacione të tjera, por të paktën do të donim që ZPS-ja të
15 mund të na jepte një emër në mënyrë që të bënim pyetje ose
16 mund të na jepte një emër ku mund të aplikojmë për ta
17 thërritur personin si dëshmitar dhe mund ta thërrasim vetë ne
18 si dëshmitarin tonë.

19 Pra, ky është pozicioni ynë lidhur me këtë pyetje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

21 Faleminderit.

22 Zoti Cadman, keni ndonjë gjë për të shtuar.

23 Zoti Pace.

24 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar.

25 Çështjet janë nxjerrë në bazë të rregullit 123 [sipas

1 përkthimit]. Ne nuk i kemi kërkuar që të pranohen si prova
2 materiale, ne nuk kemi pasur ndërmend ta bëjmë këtë. Janë këto
3 çështje të cilat kanë të bëjnë me thelbin e çështjes.
4 Megjithatë ky është vendim i Gjykatësve dhe ne i kemi nxjerrë
5 këto dokumente.

6 Megjithëkëtë, ne e kemi mbyllur këtë çështjen tonë dhe
7 nuk kemi ndërmend që të kërkojmë dëshmitarë të tjerë.

8 Avokati i zotit Gucati flet për çështjen e barazisë së
9 palëve këtu dhe nuk ka një bazë juridiksioni apo juridike që
10 një prokuror të bëjë kundërpjetje të një dëshmitari. Në mënyrë
11 më specifike, nuk na takon neve që të identifikojmë
12 potencialin e një dëshmitari të cilin mund ta shfrytëzojë
13 Mbrojtja dhe nuk do ta bëjmë një gjë të tillë.

14 I nderuar Gjykatës, ne kemi përfunduar çështjen tonë dhe
15 nuk kemi ndërmend të thërrasim dëshmitarë të tjerë për të
16 mbuluar këtë çështje. Sidomos në këtë pikë; megjithëkëtë
17 situata mund të ndryshojë. Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Trupi
19 Gjykues dëshiron të dëgjojë nga palët lidhur me afatet e punës
20 për të ardhmen.

21 Sipas rregullit 134, pasi të kemi dëgjuar kundërprova,
22 Trupi Gjykues do të duhet të njoftojë momentin kur të
23 përfundojnë procedurat e dhënies së provave dhe t'u kërkojë
24 palëve që të japin dosjen e tyre përfundimtare gjyqësore
25 brenda 30 ditëve.

1 Dhe i njëjtin rregull parashikon që deklaratat
2 përfundimtare të dëgjohen brenda 21 ditëve pas dhënies së
3 paraqitjes së dosjes.

4 Duke mbajtur parasysh këtë rregull dhe rregullin 72 të
5 procedurave të përshpejtuara, Paneli dëshiron që t'i shkurtojë
6 këto afate kohore, por së pari dëshirojmë të dëgjojmë sesa
7 mund të shkurtohen këto afate. Pra, ne po ju kërkojmë që të
8 mendoheni për një çast.

9 Dhe po e fillojmë me Prokurorinë. Nëse dëshironi të
10 mendoni për një minutë vazhdoni. E njëjta gjë vlen edhe për
11 Mbrojtjen.

12 Z. PACE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, zoti Kryetar, po
13 duam të mendohemi pak.

14 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Jeni gati,
16 zoti Pace?

17 Z. PACE: [Përkthim] Po. Faleminderit, të nderuar
18 Gjykatës.

19 ZPS-ja do ta paraqesë dosjen e saj brenda tre javëve nga
20 urdhri për përfundimin e çështjes. Pra, kjo është kur Mbrojtja
21 nuk kërkon më dëshmitarë të tjerë apo nuk ka dëshmitarë të
22 tjerë apo vendimet e tjera që mbeten për t'u vendosur
23 përfshirë edhe dëshmitarët jo gojor apo dëshmi të tjetra. Pas
24 kësaj, pra, na duhet një periudhë tre javore.

25 Pas kësaj na duhet një javë minimum për të përfunduar

1 deklaratën tonë përfundimtare.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Zoti Rees.

5 Z. REES: [Përkthim] Në fillim do të thosha që ne nuk e
6 përfundojmë [sipas përkthimit] që kjo është pjesë e rregullit
7 72 për procedurën e përshpejtuar, megjithëkëtë, e pranojmë që
8 është një fuqi më e lartë që mund të vendosë mbi shkurtimin e
9 afateve kohore dhe ka rregulla, megjithëkëtë edhe ne
10 dëshirojmë që procedurat të jenë sa më të shpejta dhe të
11 zgjidhen sa më shpejt që të jetë e mundur.

12 Dhe në këtë kontekst, jemi dakord me Prokurorinë që
13 kufiri për parashtresën përfundimtare mund të jetë brenda 30 -
14 - mund të bëhet të jetë 21 ditë. Jemi dakord me këtë.

15 Dhe pas kësaj, për sa i përket një seance apo
16 parashikimit të një seance do të kërkonim minimumi një javë
17 për të përgatitur deklaratën tonë mbyllëse.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

19 Faleminderit, zoti Rees.

20 Zoti Cadman.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe unë po i përshpejtoj
22 parashtrimet e mia dhe po them 21 ditë për dosjen
23 përfundimtare dhe shtatë ditë të tjera për deklaratën mbyllëse
24 e kjo është një procedurë e arsyeshme.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kemi

1 arritur në fund të rendit të ditës. Trupi Gjykses do të
2 pezullojë shkurtimisht seancën. Do të ritakohemi në orën
3 11.30. Na duhet që të përfundojmë disa urdhra të shkurtër.

4 Por para kësaj, a dëshiron ndonjëra nga palët të ngrejë
5 ndonjë gjë në këtë moment?

6 Zoti Pace.

7 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

8 E para, dua të përsëris që në qoftë se Mbrojtja dëshiron
9 që të shfrytëzojë provat materiale me dëshmitarët, ne duam që
10 të na lajmërojnë sa më shpejtë që të jetë e mundur. Dhe kjo ka
11 vlerë për të dyja ekipet e Mbrojtjeve, për shkak se procedurat
12 kërkojnë që lista tentative e dëshmitarëve të jepet me një
13 afat paraprak të mjaftueshëm.

14 Dhe besoj që kjo është një periudhë 24 orëshe,
15 megjithëkëtë nuk po flas për këtë çështje tani.

16 Çështja tjetër është që deklarata e 1242 të Mbrojtjes së
17 Gucatit, dëshmitari ka përmendur që ka qenë pjesë e një
18 interviste të marrë nga Mbrojtja e Haradinajt. Ne e kemi
19 përmendur që dëshirojmë të ketë një nxjerrje të deklaratave që
20 mund të dalin si rezultat i kësaj seance të marrjes në pyetje
21 dhe kjo për shkak se dëshmitari është thirrur për të dhënë
22 dëshmi dhe prandaj kjo është me vlerë. Nuk është e qartë në
23 këtë moment. Megjithëkëtë, në qoftë se nuk është marrë
24 deklaratë, nuk ka nevojë për nxjerrje të saj. Dhe këtë
25 dëshirojmë që të sqarohet.

1 Në kërkesën tonë *inter partes* ne kërkuam një gjë të
2 tillë. Dhe lista e provave materiale që ka mbetur për këtë
3 dëshmitar është pikërisht e bazuar mbi këtë deklaratë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A mund ta
5 sqaroni këtë?

6 Z. CADMAN: [Përkthim] Ajo që nuk është e qartë nga
7 deklaratata e dëshmitarit është që diskutimi është mbajtur në
8 mënyrë, si të thuash, fillestare dhe nuk ka patur informacion
9 lidhur me këtë çështje. Hetuesi jonë ka marrë një deklaratë.

10 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofon për Gjyqtarin.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Mund të bëj një parashtrim për këtë
12 çështje. Pra, është thënë fillimisht që bërë një diskutim por
13 nuk është marrë një deklaratë në këtë takim të parë. Është
14 bërë thjesht për të marrë vesh nëse ka patur ndonjë
15 informacion që ka të bëjë me këtë çështje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pra, nuk
17 ka patur dëshmitarë. Faleminderit.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Jeni dakord, zoti Pace?

22 Z. PACE: [Përkthim] Nëse s'ka deklaratë apo jo, nuk e
23 dimë. Megjithëkëtë, në paragrafin 1, Mbrojtja e Gucatit thotë
24 që:

25 "Unë jam marrë në pyetje më parë në kapacitetin e

1 dëshmitarit për çështjen Nasim Haradinaj, kryetarit të
2 Shoqatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së, në praninë e zotit
3 Cadman dhe të përkthyesit". Pra, edhe në qoftë se nuk është
4 marrë deklaratë, atëherë, nëse nuk ka patur deklaratë, nuk ka
5 nevojë për të nxjerrë por, në qoftë se është marrë një
6 deklaratë e cila mund të mos jetë --

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Besoj që
8 pse Avokati thotë që nuk është marrë deklaratë.

9 Z. PACE: [Përkthim] Atëherë, në qoftë se nuk është marrë
10 deklaratë, dakord. Po doja thjesht ta sqaroja që është marrë
11 një seancë pyetje të një personi në dëshmi si dëshmitar.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mund ta sqaroj
13 edhe njëherë. Është marrë në pyetje si një fazë fillestare nga
14 një nga hetuesit tanë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 Z. PACE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, i nderuar Gjykatës,
18 po ajo është nxjerrë nga Mbrojtja e Gucatit. Unë nuk kam parë
19 një dëshmi nga Mbrojtja e Haradinajt në këtë çështje dhe
20 prandaj kërkoj që të ketë një sqarim. Pra, duhet, më duket që
21 ka patur një deklaratë që i dhënë Mbrojtjes së Haradinajt për
22 këtë dëshmitar.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Është deklarata e saj që është
24 marrë dhe paraqitur nga Mbrojtja e Gucatit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Do të ritakohemi në orën 11.30.

3 Z. REES: [Përkthim] A mund të ngre një çështje?

4 Shkurtimisht.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po.

6 Z. REES: [Përkthim] Ne e përmendëm çështjen e një seance
7 tjetre për deklaratat përfundimtare. Dhe këtë e kemi bërë duke
8 patur parasysh kalendarin e punës si mbas rregullit 134 për
9 përgatitjen e dosjeve përfundimtare gjyqësore dhe më pas
10 afatin për caktimin e një seance të re gjyqësore.

11 Caktimi i kësaj seance gjyqësore është një çështje që nuk
12 është në mënyrë logjike, si të thuash, një çështje që ke
13 nevojë për një javë për të përgatitur këtë e kështu me radhë,
14 mbasi janë disa angazhime të veçanta të cilat lindin nga
15 nevoja e marrjes pjesë në një seancë gjyqësore.

16 Të nderuar Gjykatës, ju po shikoni mundësinë për një plan
17 pune të përkohshëm për sa i përket dëshmime dhe kjo deri më
18 datën 17 dhjetor. Në qoftë se Trupi Gjyqësor po kërkon data
19 përtej 17 dhjetorit, ne do të dëshironim që të jepnim mendimin
20 tonë para Trupit Gjyqësor pasi jemi të ndërgjegjshëm që janë
21 bërë disa pyetje lidhur me disponueshmërinë, megjithëkëtë, ne
22 dëshirojmë të jepnim mendimin tonë në mënyrë më të gjerësishme
23 kur bëhet fjalë për programin pas datës 17 dhjetor.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vazhdoni
25 atëherë, na tregoni se cilat shqetësimet tuaja. Për shembull,

1 në qoftë se flasim për pjesën e parë të janarit.

2 Z. REES: [Përkthim] Ju e dini angazhimet e mia janë të
3 atilla që unë nuk jam i disponueshëm deri më datën 28 shkurt,
4 pasi kam një angazhim për të filluar që më datën 4 janar.

5 Që në fillim ne kemi parashikuar një plan pune dhe në
6 pikën kur ZPS-ja po thoshte që çështje mund të dëgjohet në tre
7 ditë në mars për shembull. Megjithatë, ne jemi të
8 ndërgjegjshëm që duhet të kishim një kalendar pune dhe realist
9 i cili të parashikonte që gjyqi të fillonte dhe të përfundonte
10 në vjeshtën e këtij viti. Unë shpresoj që Trupi Gjykses ta
11 mbajë parasysh që ne nuk kemi shkaktuar asnjë vonesë. Ne i
12 kemi dhënë vlerësime kohore të cilat në fakt i kemi respektuar
13 apo përmirësuar. Vonesat e vetme që kanë ndodhur dhe që
14 vazhdojnë janë në lidhje me nxjerrjen e dokumenteve nga ZPS-
15 ja. Pra, Trupi Gjykses do ta mbajë parasysh që ato nuk janë
16 angazhuar për të respektuar këtë dhe prandaj do të thosha që
17 me angazhimin e duhur dhe të përshtatshëm që këto çështje mund
18 të ishin zgjidhur që më herët dhe ta kishin bërë që gjyqi të
19 përfundonte në fillim të shtatorit.

20 PËRKTHYESI: Gjykatësi nuk ka mikrofon.

21 Z. REES: [Përkthim] Jam i shqetësuar që datat për seancat
22 përmbyllëse janë të parashikuara në një ditë, në të cilën unë
23 i kam disponueshëm, pra, unë nuk jam i disponueshëm që të vij
24 ta lexoj, ta jap këtu deklaratën mbyllëse. Unë do të
25 dëshiroja, po kështu të dija, që nëse ne vazhdojmë të dëgjojmë

1 me dëshmi edhe pas datës 17 dhjetor, dua të di nëse do të jem
2 në gjendje që të marr pjesë në këto seanca.

3 A e di që këtu bëhet fjalë për një vonesë. Megjithëkëtë,
4 unë do t'i kërkoj Trupit Gjykues që të shqyrtonte javën që
5 fillon me datën 28 shkurt si java për vazhdimin e seancave
6 para këtij Trupi Gjykues duke patur parasysh disponueshmërinë
7 time pra.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Angazhimi
9 juaj në janar dhe në shkurt është i caktuar?

10 Z. REES: [Përkthim] Po. I atillë është.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk mund
12 ta ndryshoni?

13 Z. REES: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk keni
15 bashkëmbrojtës?

16 Z. REES: [Përkthim] Po. Dhe jam në duart e Trupit
17 Gjykues. Por për sa i përket deklaratës mbyllëse, unë mendoj
18 që do të duhej të bëhej nga Mbrojtësi kryesor. Unë, sigurisht,
19 që do t'i kërkoja Trupit Gjykues të mbante parasysh
20 disponueshmërinë time kur të caktojë datat për deklaratat
21 mbyllëse.

22 Si gjithnjë, ne mbetemi në duart e Trupit Gjykues për sa
23 i përket të tëra datave të parashikuara. Megjithëkëtë, kjo
24 është kërkesa ime.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pra, pas

1 datës 17 dhjetor ju jeni i disponueshëm më datën 28 mars?

2 Z. REES: [Përkthim] Më 28 shkurt.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kërkoj
4 ndjesë, pra, 28 shkurt.

5 Dakord. A dëshiron ndokush tjetër që të shtojë ndonjë gjë
6 mbi këtë çështje? Unë mendoj që nuk do të përfundojmë brenda
7 datës 17, ndonëse kishim menduar se kështu do të ndodhte.

8 Unë ju kam dëgjuar juve kur keni bërë vlerësimin e kohës
9 për sa i përket pyetjes së dëshmitarëve dhe besoj se do të
10 duhet një sasi e caktuar kohore.

11 Z. REES: [Përkthim] Po sigurisht. Pavarësisht faktit që
12 ne i kemi njoftuar plotësisht mbi mënyrën sesi do ta bënim
13 Mbrojtjen tonë dhe këtë e kemi bërë shumë herët. Kjo ka qenë
14 paraprake, pasi ne po e trajtojmë listën e dëshmitarëve si
15 pjesë e përgatitjes së kësaj konference përgatitore.

16 Megjithëkëtë, është risi për ne, është një lajm i ri që
17 kur dëgjojmë se ZPS-ja dëshiron që t'i bëjë pyetje zotit
18 Gucati për dhjetë orë me radhë. Është hera e parë që kemi
19 patur një vlerësim nga ana e ZPS-së për këtë çështje.

20 Gjatë të gjithë kohës, ne kemi kërkuar në këtë gjyq, pra,
21 që procedura e dhënies së provave të përfundonte më datën 17
22 dhjetor. Këtë e kemi bërë gjatë konferencës së përgatitjes së
23 gjyqit dhe po e bëjmë edhe në të njëjtën kohë edhe tani.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Edhe në
25 qoftë se të gjithë do të bashkëpunonim, do ta bënim një gjë të

1 tillë. Megjithëkëtë, unë dua të kërkoj bashkëpunimin e të
2 tërëve për ta përfunduar fazën e dhënies së provave brenda
3 datës 17 dhjetor.

4 Zoti Pace.

5 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, po e filloj me
6 parashtrimet e fundit nga Mbrojtja e zotit Gucati.

7 Së pari, lajmi i ri i vlerësimit tonë kohor është po,
8 është i atillë, është lajm i ri, pasi është hera e parë që
9 është kërkuar që të jap një vlerësim dhe kjo është kërkuar
10 para dy minutave.

11 E dyta, njoftimi një-javor mbi dëshminë nuk ka ndonjë
12 ndikim mbi gjatësinë e kohës së pyetjeve që bën zyra jonë. Nuk
13 na është dhënë asnjë deklaratë deri para një apo dy ditëve më
14 së voni dhe në fakt, është bazuar mbi këto deklarata që ne
15 kemi arritur të vlerësojmë se sa na duhet koha.

16 Unë nuk dua të -- nuk e kuptoj se përse çuditëni që ne
17 kërkojmë që t'i bëjmë pyetjet kryesore për dhjetë orë të
18 akuzuarit të kësaj çështjeje. Kjo nuk është çudi, pasi ne kemi
19 deklaratë të hollësishme të zotit Gucati dhe materiale me
20 shumë vlerë. Kështu që nuk është çudi fare. Ne nuk dëshirojmë
21 që ta shkurtojmë seancën e pyetjeve me qëllim të përjashtimit
22 të procedurave.

23 Vlerësimi i kohës për dëshmitarët e tjerë, për mendimin
24 tonë, është i arsyeshëm. Ne mund të përpiqemi sa të mundemi që
25 t'i shkurtojmë. Edhe ne kemi patur dëshirë apo synim që të

1 përfundonim këtë fazë sa më shpejtë që të jetë e mundur, pra,
2 të tëra procedurat në fakt.

3 Për sa i përket disponueshmërisë, është fatkeqësi që
4 Mbrojtja e zotit Gucati nuk është i disponueshëm deri në datën
5 28 shkurt. Kjo do të ishte paragjyquese, si të thuash dhe e
6 padrejtë që kjo të vononte procedurat në përgjithësi. Dhe
7 është në disfavor të të akuzuarit dhe të gjithëve, thjesht për
8 shkak të angazhimeve të tjera të Mbrojtësit. Pra, zoti
9 Gjyqtar, ne vërejmë, që e ka vërejtur me të drejtë që ka
10 avokatë të tjerë të cilët janë këtu dhe ne do ta përsërisim
11 argumentin tonë që mosdisponueshmëria nuk është arsye për të
12 vonuar më tej procedurat.

13 Mund të përfundojë lista e dëshmitarëve të zotit Gucati
14 brenda dy javëve të ardhshme. Është e mundur. Nuk e garantoj
15 dot. Askush nuk mund ta garantojë këtë dhe në fakt, kjo mund
16 ta përmirësonte paksa këtë situatë, pasi Mbrojtësi mund të
17 përfundonte pyetjet e tij të drejtpërdrejta. Dhe po të ndodhte
18 kjo, ai nuk do të ishte në gjendje që të merrte pjesë në
19 seancën kur bëhen kundërpjetjet ndaj dëshmitarit të tij, por
20 kjo nuk është një arsye për të vonuar më tej procedurat, i
21 nderuar Gjykatës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Z. REES: [Përkthim] Unë e bëj këtë parashtrim duke
25 mbajtur parasysh që do të ketë një seancë të vlerësimit të

1 mbajtjes në paraburgim dhe ndërkohë që presim përkthimin e
2 raportit të Policisë së Kosovës. Dhe ka alternativa reale, me
3 sa kuptoj unë, që të ketë një mënyrë tjetër të paraburgimit,
4 pra, një alternativë ndaj NAGJ-së.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Unë pres
6 nga të gjithë që ta kufizojnë seancën e pyetjeve të tyre tek
7 materialet më me vlerë, më relevante. Pasi kam parë shumë
8 raste kur nuk janë bërë pyetje mbi materialet të lidhura në
9 mënyrë të drejtpërdrejtë. Unë nuk -- dhjetë orë për pyetje
10 është një periudhë mjaftë, mjaftë e gjatë dhe përvoja ime nuk
11 është aq e gjatë sa e juaja, megjithëkëtë, në përvojën time
12 kam parë seanca shumë më të shkurtra.

13 Dhe unë do t'ju kërkoja juve që të mendoni për ta bërë
14 një gjë të tillë. Jo vetëm për pyetjet kryesore, por po ju
15 përkujtoj dhe juve zoti Cadman kur treguat lidhur me zotin
16 Haradinaj dhe kjo është paksa shtesë.

17 Zoti Cadman unë nuk po jua vë gishtin juve. Por po them
18 që një kohë shumë e gjatë. Zoti Cadman, vazhdoni nëse keni
19 koment, vazhdoni.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë do të jap afatin më të gjatë të
21 mundur dhe jo më të shkurtër.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit. Të njëjtën gjë që do
25 të shtoja është kjo në mbështetje të argumentit që do të

1 përfundojë e tërë Mbrojtja e Gucatit përpara. Duke patur
2 parasysh vështirësitë që mund të ketë zoti Rees.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju
4 falënderoj. E kuptoj edhe nuk është se nuk jam dakord me juve,
5 sidomos duke patur parasysh faktin, që zoti Haradinaj nuk
6 është në gjendje që të jetë i pranishëm.

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pezullohet
9 seanca.

10 --- Pauza fillon në orën 10.55

11 --- Seanca rifillon në orën 12.00

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Trupi
13 Gjykses do të lëshojë disa urdhra me gojë.

14 I pari. Është në fakt, një përmbledhje e vendimeve për
15 mocionet e paraqitura nga ZPS-ja për të hequr dëshmitarë nga
16 lista e dëshmitarëve të Mbrojtjes dhe nesër do të japim
17 vendimin me shkrim të arsyetuar plotësisht.

18 Lidhur me kërkesën e parë të Prokurorisë që është F312.

19 Trupi Gjykses do të adresojë vetëm dëshmitarë që
20 propozohet të thirren nga Mbrojtja.

21 Lidhur me dëshmitarin e Mbrojtjes Gucati 1241, 1242.

22 Ne mendojmë se disa aspekte të tyre janë me natyrë të
23 diskutueshme, por jo të tilla që të mos lejohen, sikurse ka
24 disa aspekte të dëshmisë së tyre që lidhen qartësisht me
25 çështjen.

1 Prandaj Trupi Gjykses lejon thirrjen e tyre, por i kërkon
2 Mbrojtjes së zotit Gucati që të sigurohet që dëshmia që do të
3 merret prej tyre të lidhet rreptësishtë me këtë procedura.

4 Në lidhje me dëshmitarin e Haradinajt, 1246. Trupi
5 Gjykses është i kënaqur se ajo që propozohet lidhet me
6 pretendimin e shtyrjes për vepra penale, prandaj e lejojmë të
7 thirret për atë çështje pa cenuar çështjen e disponueshmërisë
8 së veprës së nxitjes së veprës penale sipas regjimit të
9 zbatueshëm ligjor.

10 Lidhur me dëshmitarin 1250 dhe 1251. Trupi Gjykses
11 konstaton se Mbrojtja nuk ka demonstruar rëndësinë e dëshmisë
12 së tyre të propozuar, prandaj refuzon thirrjen e tyre dhe nuk
13 do ta lejojë Mbrojtjen e Haradinaj t'i thërrasë.

14 Në lidhje me kundërshtimin e Prokurorisë kundër
15 dëshmitarit 1252 të Mbrojtjes së Haradinaj, dëshmitar ekspert
16 që është F388. Trupi Gjykses konstaton se pjesë të dëshmisë së
17 propozuar të tij janë të kundërshtueshme për shkak, ndër të
18 tjera, sepse e tejkalojnë dëshminë e një dëshmitari ekspert
19 dhe futen në territore dhe përgjegjësi të Trupit Gjykses.
20 Prandaj, Trupi Gjykses nuk do t'i pranojë paragrafët e më
21 poshtëm të raportit të tij, si të palejueshëm: Paragrafi 21
22 deri 25; paragrafin 32 dhe 34, fjalinë e dytë; paragrafin 36,
23 fjalinë e dytë; dhe paragrafin 40.

24 Për këtë arsye, Trupi Gjykses e lejon dëshmitarin e
25 Mbrojtjes 1252 të thirret por do të lejojë dëshmi vetëm për

1 propozime të përgjithshme që përmbahen në këtë raport dhe në
2 ato pjesë të raportit që nuk përbëjnë dëshmi të palejueshme.

3 Në lidhje me kundërshtimin e Prokurorit kundër
4 Dëshmitarit 1253 të Mbrojtjes së Haradinaj, dëshmitari i dytë
5 ekspert që është F438. Trupi Gjykes nuk ka dyshim që është
6 një dëshmitar, një hetues penal me përvojë por pjesët e
7 propozuara të dëshmisë së tij lidhen me çështje që Trupi
8 Gjykes mund t'i vendosë vetë pa pasur nevojë për dëshmi
9 ekspert. Ka çështje ligjore faktike që i kanë ngritur çështjes
10 si pjesë e çështjes së tyre, por këto në disa raste do të
11 uzurponin përgjegjësitë e Trupit Gjykes, prandaj refuzojmë ta
12 dëgjojmë dhe nuk do ta lejoj Mbrojtjen e Haradinajt t'i
13 thërrasë.

14 Në lidhje me kundërshtimin e Prokurorisë të paraqitur
15 dje, lidhur me dëshmitarin e Mbrojtjes Gucati 1248, Trupi
16 Gjykes konstaton se nuk ka mosmarrëveshje midis palëve se
17 nenet e përmendura në këtë deklaratë të dëshmitarit gjenden
18 online, gjendeshin online në kohën e rrëfimit të tij. Prandaj
19 Trupi Gjykes merr parasysh faktin, që është rënë dakord midis
20 palëve, pa pasur nevojë të thirret dëshmitari i Mbrojtjes
21 1248. Nëse Mbrojtja dëshiron ta paraqesë si provë materiale
22 këtë, mund ta paraqesë për pranim si bazë në bazë të rregullit
23 153 siç propozohet nga ZPS-ja.

24 Lidhur me Dëshmitarin 1243 të Mbrojtjes së Gucatit dhe
25 1244, dhe 1245, dhe 1247 dhe Dëshmitarin e Mbrojtjes Haradinaj

1 1254. Trupi Gjykues është i mendimit se disa pjesë të dëshmisë
2 së tyre janë opinione, por ne mendojmë se duhet marrë apo
3 duhet ofruar si provë kjo dëshmi. Në qoftë se do të ndodhë kjo
4 Prokuroria mund të kundërshtojë marrjen e dëshmisë apo
5 pranimin e deklaratës apo pjesëve të saj, si provë materiale.
6 Trupi Gjykues konstaton se është e parakohshëm të japë vendim
7 për pranueshmërinë e tyre në këtë fazë.

8 Këtu përfundon ky urdhër me gojë.

9 Në këtë moment, dua që për një moment të ndaloj me
10 urdhrat me gojë dhe t'ju bëj pyetje Prokurorisë dhe zotit
11 Rees. Trupi Gjykues do që t'i japë leje Mbrojtjes që të
12 apelojë një pjesë të vendimit të Panelit, në qoftë se
13 dëshirojnë. Kjo do të paraqitet në vendimin tonë që do të
14 japim nesër.

15 Leja *proprio motu* ka të bëjë me Dëshmitarin 1235, 1251,
16 1253. Do të ketë kundërshtim për vendimin për pranimin për
17 leje për apelim?

18 Z. PACE: [Përkthim] Ne duam që të shikojmë kërkesën, duam
19 të shikojmë sesi është formuluar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Edhe pse
21 kjo do t'i shtyjë procedurat?

22 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e di pse do të shtyhen shumë.
23 Thjesht duke kërkuar vendimin, i cili mund të na jepet pas
24 disa orëve.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do ta

1 përcaktojmë këtë çështje në vendimin tonë që do të japim
2 nesër.

3 Zoti Rees, pasi keni dëgjuar pak a shumë thelbin e
4 vendimit që do të japim nesër, jeni në gjendje që të bëni
5 deklaratën hapëse nesër në mëngjes? Në qoftë se jo, atëherë
6 mund të prisni derisa të dalë vendimi. Po jua ofrojmë këtë
7 opion bazuar në ato që thatë me herët.

8 Z. REES: [Përkthim] Po. Do të isha gati.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vazhdojmë
10 me urdhrat me gojë.

11 Urdhri i dytë me gojë.

12 Pasi dëgjuam palët dhe sipas rregullit 119, nënparagrafi
13 4, Trupi Gjykses përcakton datën për hapjen e çështjes së
14 Mbrojtjes, data 3 dhjetor 2021. E dimë që do bëhet deklarata e
15 hapur e Mbrojtjes së Gucatit në 3 dhjetor.

16 Paraqitja nga Mbrojtja e Gucatit e provave, dëshmisë do
17 të fillojë në 6 dhjetor 2021. Trupi Gjykses autorizon
18 Mbrojtjen e Haradinajt të bëjë deklaratën hapëse pas
19 përfundimit të çështjes së Gucatit. Paraqitja e provave të
20 Mbrojtjes Haradinaj pritët të fillojë menjëherë pas deklaratës
21 hapëse.

22 Dëshmitë në këto dy çështje do të dëgjohen nga data 6 dhe
23 10, dhe 16 dhe 17 dhjetor. Dhe në qoftë se lind nevoja në
24 janar nga data 11 deri në 17.

25 I kujtojmë Mbrojtjes detyrimet e saj sipas paragrafit 59

1 dhe 62 deri në 65 të urdhrit për Zhvillimin e Procedurave.
2 ZPS-ja kujtohet për detyrimet e saj sipas paragrafit 66, 67 të
3 të njëjtit urdhër.

4 Këtu përfundon urdhri me gojë.

5 Urdhri i tretë. Lidhur me urdhrin e mëparshëm dhe vendimi
6 që do të dalë nesër, Trupi Gjykses e gjen të nevojshme të
7 lëshojë këto paralajmërime Mbrojtjes.

8 I kujton Mbrojtësin, Avokatin e Mbrojtjes që ka për
9 detyrë të drejtojë pyetjet, mënyrën e përgjegjshme të bërjes
10 së pyetjeve duke pasur parasysh vendime të mëparshme. Vërejmë
11 me shqetësim se një numër dokumentesh që janë në listën e
12 provave materiale të Mbrojtjes nuk duken se kanë lidhje me
13 procedurën.

14 Theksojmë [se] drejtësia e luftës dhe kryerja e krimeve
15 gjatë një konflikti nuk janë çështje që kanë të bëjnë me këtë
16 çështje dhe Trupi Gjykses nuk do të lejojë marrjen apo
17 paraqitjen e dëshmime të tyre. Dëshmi lidhur me karakterin e
18 luftës apo akte të paligjshme që i atribuohen vendeve, palëve
19 apo personave nuk lidhen me këtë çështje. Pyetje të bëra
20 përgjatë këtyre linjave apo përgjigjet e dëshmitarëve për këto
21 tema do të ndërpriten dhe nuk do të lejohen - si parëndësi,
22 palidhje.

23 Gjithashtu vëmë re se disa nga dokumentet në listën e
24 dëshmitarëve janë dokumente të gjatë. Në përputhje me
25 paragrafin 19 për urdhrin lidhur me procedimin, duhet të

1 përcaktohet konkretisht se cilat pjesë të këtyre dokumenteve
2 do të përdoren lidhur me çështjen në fjalë. Trupi Gjykses nuk
3 do të lejojë që të ngarkohemi me dokumente të cilat nuk do të
4 përdoren nga palët.

5 Urdhri i katërt.

6 Pasi dëgjuam palët dhe sipas rregullës 119, nënparagrafi
7 4, Trupi Gjykses përcakton si datë të synuar për mbylljen e
8 çështjes së Mbrojtjes 17 janar 2022. Duke pasur parasysh që të
9 kemi kohë të mjaftueshme për çështjen e Mbrojtjes dhe për
10 ndonjë apel të ndërmjetëm. Trupi Gjykses thekson se kjo datë
11 është një vlerësim i përafërt. Por mund të afrohet apo zgjatet
12 sipas nevojës.

13 Dhe këtu përfundon ky urdhër me gojë.

14 Urdhri i pestë.

15 Trupi Gjykses vëren se në 8 shtator 20221 në Konferencën
16 e Përgatitjes së Mbrojtjes, ne përcaktuam datën 17 dhjetor si
17 datë për mbylljen e çështjes. Pra, në këtë rast duhet të
18 vendosim një datë të re duke marrë parasysh fazën aktuale dhe
19 të procedurës dhe hapat që duhen ndërmarrë ende.

20 Trupi Gjykses thekson se këto data të synuara tregojnë
21 vlerësimet tona, por i nënshtrohen zhvillimit të procedurave
22 dhe parimit të një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë. Në këtë
23 fazë, duhet të dëgjojmë çështjen e Mbrojtjes nëse dëshiron të
24 thërrasë prova të reja nëse do të japë kundërpërgjigje për
25 provat.

1 Dhe në këtë rast do të mbajmë një seancë për deklarata
2 mbyllëse. Përcaktojmë si datë të synuar për mbylljen e
3 çështjes 1 marsin 2022. Edhe njëherë, theksojmë se kjo datë e
4 synuar është thjesht një njoftim i vlerësimit tonë, i cili
5 mund të ndryshojë. Trupi Gjykues do të presë parashtime nga
6 palët në kohën e duhur.

7 Këtu përfundon dhe ky urdhër me gojë.

8 Urdhri i gjashtë.

9 Trupi Gjykues pasi ka dëgjuar palët gjen se lista e
10 provave materiale të propozuara nga Mbrojtja e Gucatit F460,
11 Shtojca 2, mund të ruajë klasifikimin e vet publik. Trupi
12 Gjykues konstaton se mënyra sesi identifikohet çështja nuk
13 përbën shqetësim lidhur me nxjerrjen e informacionit
14 konfidencial. Kjo nuk dëmton qëndrimin e Trupit Gjykues lidhur
15 me klasifikimin e ekstraktit sipas dokumentit 25 dhe mënyra
16 sesi dëshmia mund të merret gjatë seancave publike.

17 Këtu përfundon edhe ky urdhër me gojë.

18 Urdhri i shtatë.

19 Urdhërohen të dy Mbrojtjet të parashtojnë listën e
20 përditësuar të provave materiale deri të hënën, 6 dhjetor 2021
21 në orën 16.00. Kjo nuk dëmton parashtimin e listave të
22 provave materiale të Mbrojtjes së Haradinaj sot.

23 Urdhri këtu përfundon.

24 Urdhri i tetë.

25 Urdhërohet Mbrojtja që të parashtojë, në qoftë se ka,

1 ndonjë parashtrim nga vendet e tyre dhe ZPS-në deri në qoftë
2 se dëshiron deri në 15 dhjetor 2021.

3 Këtu përfundon dhe urdhri i fundit me gojë.

4 Ka ndonjë gjë tjetër nga Trupi Gjykses?

5 Sikurse u vu në dukje nga zoti Rees, do të fillojmë nesër
6 me deklaratat hapëse dhe pres që të gjithë të takohemi përsëri
7 nesër në orën 9.30.

8 Faleminderit të gjithëve për vëmendjen, përkthyesve,
9 Sekretarit të Gjykatës dhe të të gjithëve që ndihmuan për
10 punën tonë sot.

11 Shihemi nesër.

12 --- Seanca përfundoi në orën 12.15

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25